



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1215/4 Prot.

Tiranë, më 30.05.2025

VENDIM

Nr. 58, datë 30.05.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 20 DATË 27.02.2025 “PËR KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027” TË SENATIT AKADEMIK TË UMT

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 1, neni 76 pika 2, neni 135, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Vendimit nr.20, datë 27.02.2025 “Për kriteret e pranimit...” të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe në vijim të diskutimeve në mbledhjen e datës 28.05.2025 të Rektoratit të UMT-së, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Pas pikës IV.B, të Vendimit nr.20, datë 27.02.2025 “Për kriteret e pranimit në programet e ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027” të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, shtohet pika IV.C, me këtë përmbajtje:

“IV.C. Kriteret e pranimit për kandidatët që aplikojnë në kuotat e kategorive të veçanta, në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe programet e integruara të ciklit të dytë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, janë të njëjta me kriteret e përcaktuara për kandidatët vendas në Vendimin nr.20, datë 27.02.2025 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

- i. Kategoritë e veçanta janë si më poshtë:
 - a. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit;
 - b. Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara;
 - c. Kandidatët me statusin e jetimit;
 - d. Kandidatët Romë dhe Ballkano-Egjiptianë.

- ii. Testimi i informatizuar për kandidatët sipas nënpikës i. që aplikojnë në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, për vitin akademik 2026-2027, zhvillohet vetëm në rastet kur numri i aplikantëve (sipas kategorive) është më i madh se numri i kuotave të miratuara për çdo kategori, me Vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.”
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

KRYETARI
Prof. Dr. Xheladin DRACINI

